



Tiranë, më 23.04.2024

**PARASHTRIME DHE KËRKESA**  
**(mbi aktin e ekspertimit teknik për shkaqet e shpërthimit)**

**Drejtuar:** Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar,  
**Gjyqtares, Znj.Irena GJOKA**

**Nga:** Fatmir MEDIU, përfaqësuar nga Av. Ardian VISHA, me nr.3525 Licence dhe Av.Henrik LIGORI me nr.6321 Licencë, anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë.

**Baza ligjore:** Nenet 110, 179, 357.2 të Kodit të Procedurës Penale.

**E Nderuar Zonja Gjyqtare,**

Në seancën e kaluar u njohëm me parashtrimin e akuzës mbi një sërë provash dokumentare, ku dhe posaçërisht mbi aktin e ekspertimit teknik të kryer nga një grup ekspertësh amerikanë, specialistë në fushën e eksplozivëve, akt i përfshirë në faqet 81-107 të fashikullit nr. 11 (në referencën e prokurorëve është shënuar gabimisht fashikulli nr.12).

**A.** Lidhur me aktin e ekspertimit në fjalë dëshirojmë të paraqesim në vijim disa aspekte që lidhen me procedurën dhe me garantimin e të drejtave të të pandehurit Fatmir MEDIU:

1. Akti i ekspertimit teknik paraqitet në formën e një raporti hetimi dhe është nënshkruar nga Anthony L. May, Larry R. Smith dhe Peter J O'Connor, ndërkohë që na rezulton se deklaratën e ekspertit sipas nenit 183/1 të KPP e kanë nënshkruar vetëm dy të



- parët. Theksojmë se në grupin e ekspertëve që kanë marrë përsipër hartimin e këtij raporti hetimi, kanë marrë pjesë edhe Dondi Albritton (agjent special i ngarkuar i grupit), Michael Eldredge (oficer i ngarkuar për lëndët shpërthyesë) dhe Kenneth Whiteley (agjent special). Këta të fundit ndonëse janë pjesë e grupit të ekspertëve të vënë në dispozicion nga Zyra e Alkoolit, Duhanit, Armëve të Zjarrit dhe Lëndëve Shpërthyesë (ATF) të SHBA-së dhe citohen si pjesëmarrës në hartimin e këtij raporti hetimi, nuk kanë nënshkruar aktin dhe nuk janë thirrur për të kryer procedurën e betimit.
2. Në aktet e fashikullit të cituar nga Prokurori nuk gjejmë vendimin për caktimin e personave të sipërcituar në cilësinë e ekspertëve dhe nuk dimë se çfarë pyetjesh iu janë shtruar atyre për zgjidhje nga organi i akuzës.
  3. Për shkaqe që dihen, i mbrojturi prej nesh Z.MEDIU nuk ka qënë palë në procesin e zhvilluar për këtë ngjarje para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kësisoj, ai ka qënë në pamundësi për të debatuar lidhur me përmbajtjen e aktit dhe konkluzionet e tij.

Për arsyet që renditëm më sipër, me qëllim rindërtimin e kontradiktoritetit në proces lidhur me marrjen e kësaj prove me natyrë shkencore, kërkojmë që i pandehuri dhe mbrojtja e tij të kenë mundësi që t'ju drejtojnë pyetje ekspertëve amerikanë për të sqaruar paqartësitë lidhur me rolin e tyre në kryerjen e këtij akti dhe për të sqaruar paqartësitë lidhur me përfundimet e arritura prej tyre. Gjithashtu, kërkojmë që akuza të na vendosi në dispozicion vendimin për kryerjen e ekspertimit dhe në mungesën eventuale të tij, të sqarohen shkaqet e kësaj mangësie formale.

Po ashtu, kërkojmë të njihemi nëse kanë pasur ndonjë mendim ndryshe ekspertët Dondi Albritton, Michael Eldredge dhe Kenneth Whiteley, të cilin nuk e gjejmë në fashikujt përkatës të vënë në dispozicion nga organi i akuzës. Pra, kërkojmë të dimë nëse ka pasur shkaqe për



ometimin e tyre për mungesën e nënshkrimeve të tyre në aktin e ekspertimit teknik.

Në raportin e ekspertëve amerikanë në kapitullin “Përfundime”, në pikën “61”, është përcaktuar se *shkaku ekzakt i zjarrit është i panjohur, megjithëse ka disa kushte të punës, që mund të kenë çuar në nisjen e zjarrit, duke filluar nga thasët e lëndëve plasëse. Siç është deklaruar paraprakisht lëndët plasëse si baruti i zi dhe baruti pa tym me dy baza, janë shumë të ndjeshëm për marrje flake nga prodhimi i nxehtësisë, elektriciteti statik, fërkimi ose flaka.*

Në pikën “62” të këtij akti ekspertimi është vendosur një listë e burimeve të mundshme të ndezjes, bazuar në provat e mbledhura, si dhe informacioni i marrë prej dëshmitarëve. Pra, ekspertët kanë përcaktuar pesë hipoteza të mundshme të ndodhjes së shpërthimit.

Në paragrafin “4” të pikës “62” flitet për burim të hapur flake dhe mungesën e kontrollit të personave që punonin në Gërdec për çakmak, shkrepse apo materiale të tjera që përdoren për ndezje zjarri përpara se të hyjnë në fabrikë.

Këto hipoteza nuk përjashtojnë mundësinë e vendosjes së qëllimshme të zjarrit, për synime të cilat janë shprehur si qëndrime në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare në datën 21.03.2008 nga drejtuesit e shërbimeve inteligjente. Drejtori i SHIU-t ka dëshmuar gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me informacione që ai ka marrë gjatë takimit në Bruksel me drejtuesit e lartë të Zyrës NOS (Zyra e Sigurisë së NATO-s), për mundësi të kryerjes së akteve të sabotimit. Drejtori i SHIU-t këtë informacion ia ka përcjellë me shkrim para ngjarjes në Gërdec autoriteteve më të larta shtetërore. Ekspertët që kanë hartuar aktin duhet të pyeten edhe për kërkimet që kanë kryer mbi hetimin e një shkaku tërësisht të mundshëm, sikundër është një akt i qëllimshëm, i kryer për motive të sigurisë kombëtare apo për shkak të konkurrencës në biznes.

Duke iu rikthyer shkaqeve të shpërthimit të cilat parashtrohen jo vetëm në akt, por edhe në parashtrimet e paraqitura nga prokurorët (faqet 2-4), vërejmë se shkaku i parë i ndezjes së barutit dhe të shpërthimit të mëvonshëm ka qenë transferimi i nxehtësisë nga karroca e salduar. Në



këndvështrimin e mbrojtjes, mbështetur në aktet e procesit dhe në provat e administruara gjatë këtij gjykimi, ky shkak është hipotetik dhe tërësisht i paargumentuar për arsyet që do parashtrojmë në vijim:

- a) Asnjëri nga dëshmitarët e akuzës të dëgjuar nga kjo gjykatë nuk dëshmoi se ishte pikërisht karroca e salduar ajo që mori flakë.
- b) Sipas deklaratës së dëshmitarit Fejzi Shehu, roje në objekt, karroca e fundit e salduar ka hyrë 30 minuta para shpërthimit. Po ta lidhim këtë deklaram me eksperimentin e kryer nga ekspertët amerikanë (lexo raportin e hetimit), del qartë se zjarri nuk ka ardhur nga saldimi, sepse sipas tyre mbas 2 minutash temperatura e saldimit ulet ndjeshëm dhe nuk mundet që baruti të marrë flakë.
- c) Një karrocë metalike, në një sipërfaqe të pjerrët me pengesa në daljen nga bodrumi dhe kapërcimin e portave të objektit, në një distancë mbi 30 metra, nuk mund të përshkruhet për 2 minuta.
- d) Prokuroria hamendëson kur thotë se; i ndjeri Qemal Deliu, mbasi ka salduar karrocën, nuk e ka ftohur. Këtë vlerësim të prokurorisë apo ekspertëve, nuk e mbështet asnjë dëshmitar ose provë tjetër. Ata që njihnin Qemal Deliu kanë deklaruar se ai kishte eksperiencë dhe ishte shumë i kujdesshëm në punë. Për më tepër, nëse ka marrë flakë karroca që ai ka salduar dhe me të cilën ai punonte, është krejt e anormale një neglizhencë ekstreme nga ana e tij, që do t'i kushtonte jetën atij dhe familjes.
- e) Djali i të ndjerit Qemal Deliu, z.Uran Deliu, në procesin gjyqësor ndaj Fatmit Mediut, ka deklaruar se; *"në ditën e ngjarjes ka qenë në shtëpi deri në momentin e shpërthimit në kopësht, duke rregulluar hardhitë dhe nuk është takuar me të jatën, të ndjerin Qemal Deliu, sepse ai nuk ka ardhur atë paradite në shtëpi dhe e kishin lënë të takoheshin në orën 12, kur ai të vinte për të ngrënë bukë dhe z.Uran do t'a zëvendësonte atë për shkak se duhej të bënin normën e punës"*

Gjithashtu, ndaj pyetjeve të prokurorëve të seancës dhe të avokatit Ardian Visha, përgjigjet e dëshmitarit Deliu po në këtë proces, konfirmojnë



se nuk qëndron fakti i saldimit të një karroce nga i ndjeri babi i tij Qemal Deliu. Po riprodhojmë në vijim pjesë nga debati në seancë gjyqësore:

Prokurori: *A dinte babai t'a përdorte saldatricen?*

Uran Deliu: *Po patjetër.*

Av. Ardian Visha: *Duke qenë se ishe në banesë, po rregulloje vreshtin, nga vendi që ishit duke rregulluar vreshtin, mundeshit të dallonit hyrjen e një njeriu në banesë, kushdo qoftë ky, babai apo kushdo tjetër?*

Uran Deliu: *Patjetër po.*

Av. Ardian Visha: *Po qe se do vinte, do e dallonit?*

Uran Deliu: *Po qe se do vinte babai, do ikja unë në vend të babait dhe do rrinte babai të rregullonte hardhinë.*

Av. Ardian Visha: *Ju përjashtoni në mënyrë absolute faktin që babai juaj të ketë ardhur në banesë dhe të ketë salduar një karrocë?*

Uran Deliu: *Patjetër.*

Av. Ardian Visha: *Hardhitë ku ndodhen në raport me shtëpinë?*

Uran Deliu: *Diku 10 metra. Ajo (saldatricja) ka qenë në bodrum, me shkallë përballë bodrumit, drejt me fabrikën, me rrugën kryesore.*

Ka edhe disa fakte të tjera, të cilat e bëjnë të paarsyeshëm versionin hipotetik e shkaktimit të zjarrit nga saldimi i karrocës. Kështu, veç distancës të matur me kompjuter, nga vendi i supozuar i saldimit, deri në vendin e supozuar të karrocës së shpërthyer, është evidente se:

- a) Koha e lëvizjes së karrocës deri në destinacion, është më e gjatë se ajo e përshkrimit të një distance 30 m në vijë të drejtë nga një këmbësor, dhe ndryshe nga një punëtor që tërheq në kalldrëm/rrugë një karrocë me rrota metalike me diametër 100 mm.
- b) Është pohuar gjatë hetimit gjyqësor se; saldimi bëhej në një bodrum



të ndërtesës, kapërcehej dera e shtëpisë së saldatorit. Në vijim, kapërcehej dera e fabrikës (dera e vogël) sic pranohet nga dëshmitarët, e cila ishte e mbyllur me shul dhe hapej për cdo hyrje e dalje.

- c) Roja ishte caktuar vetëm një ditë më parë në atë punë, dhe siç u dëshmuar, ishte shumë rigoroz në hapjen/mbylljen e derës, dhe nuk neglizhonte.
- d) Dera e vogël e fabrikës kishte një prag metalik 25 cm për t'u kapërcyer karroca me punëtorin. Pas derës kryesore të hyrjes ishte një derë tjetër për të hyrë në sheshin e fabrikës. Të gjitha këto dyer të mbyllura u kaluan derisa karroca erdhi në vendin e pretenduar të ngarkimit me barut.

Si konkluzion, koha është shumë më e gjatë në raport me kohën që nevojitet për të përshkruar 30 metra të matura në vijë ajrore.

Në pikën 6 të Aktit, duke ju referuar dëshmitarëve, ekspertët përcaktojnë vendin ku dëshmitarët panë për herë të parë zjarrin, por nga dëshmitë nuk del se cili ishte shkaku i zjarrit. Disa dëshmitarë pretendojnë se erdhi nga poshtë karrocës, disa të tjerë nga sipër karrocës.

Për arsyet e mësipërme dhe referuar faktit se ekspertët kanë arritur në përfundimin për pesë shkaqe të mundshme të shkaktimit të zjarrit, për të nxjerrë përfundime të drejta në interes të së vërtetës, kërkojmë të urdhërohet, për qëllime prove **kryerja e një eksperimenti në kushte të përafërta me rrethanat kur u shkaktua zjarri për të përcaktuar mundësinë apo pamundësinë e shkakut të saldimit në ndezjen e barutit**. Ky eksperiment është një provë e arsyeshme në interes të së vërtetës për shkak se një eksperiment i tillë është kryer dhe nga ekspertët amerikanë, fakt që përshkruhet në përmbajtje të raportit të hetimit (faqe 10, parg. 32) .

Në përmbajtje të raportit të hetimit (faqe 12, parg. 42-47), pasqyrohen deformimet në sipërfaqen e një karroce, që supozohet se mund të ishte





karroca e ngarkuar me thasë baruti, ku dëshmitarët panë për herë të parë flakë dhe që i ka dhënë asaj një formë të lugët. Ekspertët supozojnë se deformimi ka ardhur për shkak të ndezjes së barutit, që ka ushtruar një forcë pingule me kahje nga lart – poshtë, dukuri që ka lënë gjurmë edhe mbi betonin ku ishte mbështetur karroca.

Kjo hipotezë e ekspertëve është shumë e dyshimtë dhe vjen ndesh me një përvojë elementare njerëzore që në një mjedis të hapur e bën të pamundur faktin e ushtrimit të forcës në drejtim të bazës së karrocës, ndërkohë që energjia e gazrave të djegies nuk kishte pengesa të përhapej në ajër. Për këtë arsye, **kërkojmë kryerjen e një shtesë ekspertimi që të sqarojë këtë përfundim, sipas këndvështrimit tonë të pambështetur**, duke thirrur një grup ekspertësh, që të ketë në përbërje të tyre specialistë të lëndëve djegëse dhe një fizikant, për të bërë përllogaritjen e forcave dhe mundësinë e deformimit të karrocës për këtë shkak .

**B.** Lidhur me përgjegjësinë penale që buron nga kontributi i supozuar i Z. Mediu në zhvillimin e lidhjes shkakësore.

Në seancën pararendëse përfaqësuesit e akuzës paraqitën si provë aktin e ekspertimit për shkaqet e shpërthimit, por nuk pranuan të përmbushin barrën e provës. Sikundër mbrojtja parashtroi me këtë rast, ata nuk treguan se çfarë provonte ky akt ekspertimi lidhur me fajësinë e Z.Mediu. Kjo mënyrë procedimi jo vetëm invertei barrën e provës duke i kërkuar mbrojtjes të argumentojë pafajësinë, por nuk orienton as debatin këtë seancë lidhur me pretendimet e akuzës.

Për këtë arsye, i kërkojmë gjykatës që të ftojë përfaqësuesit e akuzës që të orientojnë debatin, duke përmbushur detyrimin e tyre për të provuar faktin që ata pretendojnë, nëpërmjet parashtrimit në mënyrë të qartë dhe të saktë se çfarë faktesh provon akti në fjalë në raport me përgjegjësinë penale të ish-Ministrit të Mbrojtjes Z. Fatmir Mediu. Në këtë aspekt, mendojmë se do të ishte e rëndësishme që akuza të tregonte se si lidhen veprimet/mosveprimet e Z.Mediu me shpërthimin e ndodhur në mesditën



e 15 Marsit 2008 . Me fjalë të tjera, është detyrimi i akuzës që të provojë para kësaj gjykate se shkaqet hipotetike të shpërthimit në Gërdec janë të lidhura në mënyrë determinante me veprimet/mosveprimet e Z. Mediu.

Pasi akuza të orientojë këtë debat, mbrojtja është gati që të parashtrojë argumentet e saj mbi pabazueshmërinë e kësaj pjese të akuzës.

**Me Konsideratë,**

**Av.Henrik LIGORI**

**Av. Ardian VISHA**